


30/10/2023

Apostujt Kleopa, Terti, Marku, Justi, Artemai nga të 70-t. Dëshmorët Zinovi e Zinovia



E hënë, 30 tetor 2023 - Shenjtori i ditës

Apostujt Kleopa, Terti, Marku, Justi, Artemai nga të 70-t. Dëshmorët Zinovi e Zinovia.



- APOSTUJT TERTI, MARKU, JUSTI, ARTEMAI NGA TË 70-t -
Ishin në grupin e 70 apostujve të Zotit.

Terti u bë episkopi i dytë i Ikoniumit pas Sosipatrit. Nën diktimin e shën Pavlit, ai shkroi letrën drejtuar romakëve (Rom 16.22).

Marku, nipi i shën Varnavës (Kol.4.10), ishte episkop i Apolonisë dhe spastroi kultin e idhujve nëpërmjet predikimit të Ungjillit.

Justi, i quajtur ndryshe Jisu, ishte episkop i Elefteropolit, dhe nëpërmjet fjalës së tij dhe mrekullive tërhoqi në besim banorët e vendit.

Artemai ishte episkop i Listrës. Që të katërt fjetën në paqe pasi e lavdëruan Perëndinë me jetën dhe fjalën e tyre.

* * * * *

- APOSTULL KLEOPA -

Shën Kleopa bënte pjesë në grupin e 70 apostujve të Zotit. Vetë atij dhe Llukait iu shfaq Krishti ditën e Ngjalljes, kur shkonin nga Jerusalemi për në Emaus. Teksa flisnin për ngjarjet e Pësimit, Krishti iu shfaq, por ata nuk e shikonin. Ata i treguan komplotin e kryepiftërinjve dhe krerëve të judenjve kundër atij që e besonin se ishte Mesia, që duhet të çlironte Izraelin. Rrëfyen se kishin dëgjuar miropurëset të flisnin për Ngjalljen e Tij, por nuk besonin. "O të marrë dhe të vonuar në zemër për të besuar gjithë ato që folën profetët. A nuk duhej t'i pësonte këto Krishti, dhe të hynte në lavdinë e tij?" (Lluk. 24.25,26).

Atëherë ai u shpjegoi profecitë që përmbante Shkrimi lidhur me veprën e shpëtimit.

Kur erdhi mbrëmja dhe si mbërritën në Emaus, u ulën së bashku për të ngrënë. Edhe ashtu si në Darkën Mistike, Zoti mori bukë, e bekoji dhe ua dha. Në atë kohë atyre iu hapën sytë dhe e njohën. Por iu zhduk prej syve, duke vërtetuar kështu për brezat e ardhshëm se prania e Tij në Eukaristinë e shenjtë është shenja e vërtetë e Ngjalljes së Tij.

Llukai dhe Kleopa e kuptuan atëherë se përse u digjeshin zemrat teksa u shpjegonte Shkrimet dhe u nisën më pas për të gjetur apostujt në Jerusalem.

* * * * *



- DËSHMORËT ZINOVI E ZINOVIA -

Shën Zinovi dhe motra e tij, Zinovia, vinin nga qyteti i Egjeit, në Kiliki. U rritën me mësimet ungjillore nga prindër të perëndishëm dhe kur këta vdiqën, të tërë pasurinë e shpërndanë te të varfrit. Zinovi, i cili kishte mësuar shkencën e mjekësisë, shëronte falas të gjithë ata që vinin pranë tij, duke përdorur shumë pak

ilaçe dhe këshillonte të thoshin në lutje emrin e Jisuit, i Cili është i vetmi që mund të të shpëtojë në këtë jetë dhe në tjetrën.

Rreth vitit 290, perandori i pamëshirshëm Dioklecian dërgoi në Kiliki Lisian, një prefekt të urryer dhe të papajtueshëm për të persekutuar të krishterët. Kur Lisia dëgjoji për çuditë e Zinovit, i cili për hir të dashurisë dhe dhembshurisë që kishte për të gjithë, ishte zgjedhur episkop i Egjeit, e thirri përpara gjykatës që të mohonte Krishtin, me mendimin se kështu do të vepronte e tërë dioqeza e tij. Shenjtori nuk iu frikësua torturave, madje pohoi Krishtin dhe se dëshira e tij e vetme ishte të vdiste për Të, që të fitonte jetën e përjetshme. E shtrinë në një trekëmbësh dhe ia shqyen tërë gjymtyrët e trupit.

Kur motra e tij, Zinovia, mësoi për arrestimin e të vëllait, vrapoi në vendin e torturave dhe kur pa ato skena nuk mundi dot ta përmbante zemërimin kundër qeveritarit. Ky i fundit u përpoq ta zbuste, por pastaj e kërcënoi se do ta keqtrajtonte dhe do ta shndërronte në turp para njerëzve. Asgjë nuk e bindi. E morën edhe atë dhe bashkë me vëllain i shtrinë në dy shtretër hekuri mbuluar me thëngjij. Mbetën të paprekur, sepse një vesë hyjnore i freskonte. I hodhën në një kazan me ujë që vlonte. Pastaj i nxorën jashtë qytetit dhe ia prenë kokën, duke iu vënë kështu kurorën e martirëve.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)